

## EQREM ÇABEJ

## MBI DISA RREGULLA TË FONETIKËS HISTORIKE TË SHQIPES

Formimi e ndërtimi i sistemit të tingujve dhe shkallët e ndryshme të ndërrimit fonetik, bashkë me strukturën morfologjike dhe me elementet kryesore të fjalorit, i kanë caktuar gjuhës shqipe që me periodën e saj prehistorike si dhe në rrjedhë të zhvillimit historik karakterin e saj të veçantë dhe i kanë shënuar vendin e saj në rrethin e idiomave motra indoeuropiane. Ky ndërtim në vijat kryesore të tij u përcaktua nga mendja sistematike e Gustav Meyerit; megjithatë, edhe pas modifikimeve e plotësimeve që i bënë më vonë Holger Pedersen, Norbert Jokli e të tjerë dijetarë doktrinës së tij, kanë mbetur të hapëta shumë probleme. Këto tani, me një shqyrtim të ri të materialit dhe me një rrokje më rigorozë të ligjeve të brendshme të gjuhës, mund të arrihet që në mjaft pika t'i afrohen zgjidhjes së tyre.

Këtu dëshiroj të marr në shqyrtim në lidhjen e tyre disa nga çështjet e fonetikës historike të shqipes, të cilat për një pjesë janë trajtuar edhe më parë.

1. Në vokalizëm dallimet e kuantitetit ruhen mjaft mirë në ligjërimin përfullor, sidomos në fushën dialektore, në këtë mënyrë, që zanoret që mbainë theksin, ashtu si dhe në gjuhë të tiera, ndër gjuhët ballkanike p.sh. në greqishten e re<sup>1</sup>, shqiptohen disi më të gjata se të pathekset. Këto dallime, në literaturën e vjetër si të Shqipërisë si të kolonivet arbëreshe të Italisë jugore e të Sicelisë, ndryshe nga ç'ngjet sot në gjuhë të shkrimit, dalin në dukje dhe grafikisht, në mënyrë që gjatësitë në dallim nga shkurtësitë ose nga gjysmëgjatësitë shënohen me zanore dyfishe. Ndryshimet që ekzistojnë midis rrokieve të gjata dhe io të gjatave janë me të vërtetë relevante edhe në vështrimin fonologjik, duke përbërë dhe opozicione gramatikore ose kuptimore: *Geg. dy djelm: dÿ vajza*, në Jug çamërisht *di djelm: di vajza*<sup>2</sup>; te Gjon Buzuku *karitati nukë ban as ndonjë kafshë pë kujtuom parë, nukë ban me superbë* «caritas... non agit perperam, non inflatur»: *bân gjithë kafshëtë* «omnia suffert»: *Bajmë njerinë mbë she-mbëlltyrë tanë* «Faciemus hominem ad imaginem, et similitudinem nostram»: *e përse edhe të mos bënëjmë të keqtë qi neve na dërgon?* «mala quare non suscipiamus?»<sup>3</sup>. Rrokjet e gjata marrin vlerë edhe në metrikë.

1) Për greqishten e re khs. A. Thumb, *Handbuch der neugriechischen Volkssprache* 4.

2) Në Shpal të Tiranës edhe pa emër, *dy* «dy bij», *dÿ* «dy bija», sipas një kumtimi të Seit Mansakut.

3) XL/2, Korintasit I 13, 4 e 7. — LIX/2 = LXIX/2, Gjenezë 1, 26; LXXXX/2 = CX/2, Jobi 2, 10.

Kështu te Pjetër Budi gjatësitë numërohen dy mora, p.sh. (Doctrina Christiana 175) *I madh gjyq e mënî*, ku *gjyq* lexohet *gjyyq*<sup>4</sup>.

Përsa i përket shpjegimit të gjatësisë ose të zgjatimit të një zanorje të theksuar, dijetarë të ndryshëm janë shprehur aty me mënyra të ndryshme; pjesërisht e kanë shpjeguar me vendin që ka ajo përbrenda fjalës, pjesërisht me karakterin (edhe numrin) e konsonanteve që ndjekin, që vijnë pas, e pjesërisht me zhdukjen e ë-së së pathekse fundore, zhdukje që sjell një zgjatim kompensator. Pa mohuar ekzistencën e gjatësive natyrale e pozicionale edhe në gjuhën shqipe, edhe pa mohuar vlerën e shpjegimeve më sipër, duhet bërë vërejtja që këto shpjegime rrokin më fort fazat e reja të zhvillimit të gjuhës dhe që përveç kësaj nuk i dalin zot gjithë kompleksit të problemit. Për të arritur këtë do shikuar ky problem në rrjedhën historike të dukurive, duan vështruar proceset e mëpastajme në lidhje me më të përparmet. Aty vihet re se përbrenda pozicioneve të barabarta ka kuantitete të ndryshme, opozicione fonematike, me një anë rrokje të shkurtëra, m'anë tjetër të gjata, edhe kur janë të pathekse. Kështu ka ndër të tjera në fund fjale *u la* (nga *lë*) përballë *u lā* (nga *laj*), *u tha* (nga *thom*) përballë *u thā* (nga *thaj*), për ta: *kā* «kau», ai *kā*, na «ne»: *vā*, pa eja: *pā hala*, ma «më e»: *mā* ndajfolje, dhe «edhe»: *dhē* «dheu», dje: *jē*, drē «droje», bē, ti: *mī*, *thī*, *kā* u «unë»: *ū* «uria», *kētu: drū*, aty: *kỹ* idealisht nga një \**kēý*; në trup fjale, në rrokje të mbyllura e të hapëta, p.sh. *mal: Pāl*, *kall: djāll*, *ban* «bën»: *bān* «mban», *djalë: kālē*, *gënjej: lēj*, *ndjek: mjēk*, *et, vjet, i vet: dēt*, *mendohe: pēndohem*, *lis: parrīz parris*, *mish: trīsh*, *lut: kūt*, *mbyll: hỹll*; nga trajtat e një fjale të vetme khs. ti: *tỹ çam. tī*, *dy* mashk.: *dỹ fem.*, *tre: trī fem.* Këto ndryshime kanë arësytën e tyre historike. Gjatësitë rrjedhin për një pjesë prej gjatësish origjinale, sikundër na tregon një krahasim me gjuhët e afra me shqipen, p.sh. *mī*: gr. *μῦς* lat. *mūs*, *thī*: gr. *ῥς* lat. *sūs*, po m'anë tjetër *vjet*: gr. *Ἔτεος* lat. *vetus*. Për një pjesë tjetër, më të madhe, gjatësitë në ekonominë gjuhësore janë përfutuar përbrenda gjuhës si një lloj kompensimi për rënien e një rrokjeje fqinje, më fort të rrokjes ndjekëse, pra nëpër një kontraktion (diftongjesh ose zanoresh të barabarta ose të ndryshme) që përftohet n'atë mes nga puna e shkrirjes së disa tingujve nën ndikim të akcentit dinamik. Kjo gjë vërehet mirë te huazimet latine, dhe mund të paravendohet dhe për fjalët e trashëguara, me anë të metodës krahasimtare. Khs. p.sh. *bēkoj* nga lat. *benedico*, *djāll* nga *diabolus*, *kālē* në lidhje me lat. *caballus*, *kūt* nga *cubitus*, *mjēk* nga *medicus*, *parrīz parris* nga *paradisus*, *pēndohem* nga *poeniteri*, *prē* nga *praeda*, *pỹll* nga *padūle*, *shpīrt* nga *spiritus*, *zhūr shūr* nga *saburra*; nga fjalët e trashëguara bē: sllav. *bēda* «shtrëngim, mjerim, nevojë», lat. *fīdes* etj.; e *vē*, prej një baze \**vīdhevā*, lat. *vidua*, got. *widuwō*; *vē* nga *voe*, lat. *ovum*, gr. *ὄv*; *dēt*, nga një \**deub-eto*, e afër me lit. *dubūs* «i thellë». khs. për kuptimin *dēt* «profundum» te fjalori i Bardhit, një mbiemër i substantivuar ashtu si *prej sē dēttit* «për sē thelli» i shqipes së Greqisë, që jep Reinholdi te Glosari i Noctes pelagicae f. 55. Nuk mohohet që këto rregulla në rrjedhën e zhvillimit të gjuhës kanë pësuar mjaft trubullime, nga interferencat e ndryshme, nga ndikimet e analogjisë etj., sikundër mund të vihet re që nga Pjetër Bogdani e këtej, në veprën e të cilit Cuneus prophetarum të vi-

4) Për arbërishten e Kalabrisë G. Ferrari (Bul. Univ. Shtet. të Tiranës, Seria shk. shoq. XIII, Nr. 1, f. 82) jep *kāā* «ka-u», *kāa* «ai ka», *ka* «nga, prej».

tit 1685 nuk zbatohen më në mënyrë aq rigorozë. Me gjith'atë vijat kryesore paraqiten të qarta, dhe mendimi i gjuhëtarit të merituar arbëresh Marco La Piana, që thotë se zanoret që në krye të herës të gjata, të gjitha u bënë të shkurtëra në gjuhën shqipe që para depërtimit të elementit latin<sup>5</sup>, në këto rrethana nuk mund të mbahet. Një vlerësim i drejtë i dukeve (efekteve) të kësaj rregulle fonetike hap perspektiva të reja edhe për etimologjinë e shqipes. E tregojnë këtë ndër të tjera *hÿj hÿj* (Budi, *Rituale Romanum* 15 *aspak s munë hinjë*), *pÿj, mpÿj mbÿj*, të cilat pas mendimit tim burojnë përkatësisht nga një *\*hodiniō*, më e lashtë *\*sodiniō*, nëpërmes të një *\*hëinj* të shqipes: sllav. e vj. kishtare *choditi* «incedere», rus. *vchod* «hyrje» *ischod* «dalje», gr. *ὁδός* «udhë, rrugë» etj., e nga një *\*paginio* *\*pëinj*: gr. *πάγος* «akull, ngricë». Le të krahasohet edhe *i lë* «i lehtë»: lat. *levis*, gr. *ἐλαχός, lëj* «lind, lindem»: lat. *lectus* «shtrat» got. *ligan* «me ndejtë ratë» *lagjan* «me vendue, me vu» sllav. e vj. kishtare *lezati* «*κεῖσθα*» gr. *λέχεται* : *κοιμάται*, nga Bardhi *me flūruem* «volare» nga *fluturonj* me anë të një haplogjije, si dhe *trazoj*, pas mendimit tim prej it. *travasare* «hedh (verën) nga një enë në tjetrën, toçis», khs. prej Buzukut *ndë (h)ereditat të pā ndonjë të keq e të pā ndonjë të trāzuom* «in hereditatem incorruptibilem, et incontaminatam»<sup>6</sup>. Mendimi i R. Schmitt-Brandtit (*Kratylos* XIII 15) që humbja e korelacionit të kuantitetit të zanoreve në toskërishten, si një zhvillim më vete i këtij dialekti, u shpjeguaka me anë të një haplogjije, u shtruar nga ana e greqishtes së mesme e të së resë, nuk ka si mbahet. Kundra tij flet edhe vetë rrethana që në dialektet arbëreshe të Italisë, të shkëputura nga dheu mëmë sot e nja pesë shekuj më parë e që kryesisht flasin toskërisht, raportet e kuantitetit janë krejt të gjalla, duke u ruajtur bile edhe më mirë se në gegërishten. Kjo gjë dëshmon që rrafshimi i këtyre raporteve u krye më vonë, në periодin turke të gjuhës, në rrymën e një zhvillimi të brendshëm e modernizues të saj.

Duke përmbledhur do të themi se kuantiteti për periодin letrare të gjuhës mund të rrokët në zhvillimin e tij, po për periодin prehistorike e paraletrare të saj vetëm pjesërisht mund të rindërtohet. Shihet n'atë mes se shqipja gjatësitë e trashëguara prej kohës prehistorike i ka ruajtur vetëm në disa fjalë njërrrokëse si *mī, thī, vë, dët, lëj*, po përndryshe i ka bjerrë kryekrejt dhe ka krijuar gjatësi të reja. Në rrjedhë të historisë së saj kjo gjuhë ka kaluar gjithmonë e më shumë nga dallimet fonologjike të kuantitetit të zanoreve në dallime të tilla të kualitetit (cilësisë) të tyre; kështu aty edhe apofonia e lashtë kuantitative u bë apofoni kualitative. Për periодin letrare, mbi dëshminë e historisë së shkrimit, vihet re se — sikundër u tregua dhe më sipër — kuantiteti si një mjet i diferencimit gjuhësor, i dallimit të formave gramatikore e të fjalëve, në fillimet e traditës letrare qëndronte në krye të vendit. Kjo vlen sidomos edhe në krahasim me nazalitetin, i cili, ndonëse në gegërishten edhe ky është fonematikisht relevant, në literaturën e vjetër nuk shfaqet në shkrim, ndërsa në fazën e fundit të shkrimit të gegërishtes shënohen bash zanoret nazale, po jo me gjatësitë. Nga pikëpamja e normës gjuhësore është për të vënë re se vlera fonematike e kuantitetit si një mjet për diferencim leksikor e gramatikor, në shqipen sot është rrudhur në pak rase, nga të cilat disa u përmendën më lart. Gjatësitë e shkurtësitë në bisedën e lirë fone-

5) *Studi linguistici albanesi*, Varia (1949) f. 6.

6) LXXXV/2 = CV/2, *Letra e Pjetrit* I 1, 4.

tikisht realizohen, po fonologjikisht shumë pak shtihen në punë. Në këtë pikë shqipja, në dallim nga disa të tjera gjuhë europiane, ka kaluar në kuantitetin izokron të zanoreve. Krah për krah me këtë ka vepruar një tendencë për shkurtrim të zanoreve së paku në disa rasa të caktuara. Kështu që te Gjon Buzuku 1555 vihet re në afërsi fjalësh me një rrckje të gjatë një shkurtrim i zanoreve të gjata si rrjedhim i tempos së shpejtë të ligjërimit e si një dukuri e ritmit të fjalisë, të kompensimit të shoqishojmë e të alternimit ritmik të gjatësive me shkurtësitë, me ruajtje të ekuilibrit fonik-muzikor të fjalisë. Sikundër shihet, e njëjta fjalë mund të paraqitet me kuantitet të ndryshëm të zanoreve të theksuara sipas vendit që ka ajo brenda fjalisë<sup>7</sup>. Për shkurtrimin në rasa të caktuara, i cili fonologjikisht është i krahasueshëm me denazalizimin në gegërishten, khs. p.sh. *bē*: *besë*, dy fjalë që etimologjikisht lidhen në mes të tyre.

2. Shqyrtimi i reflektimit të diftongjeve indoeuropiane në gjuhën shqipe na tregon se ato janë reduktuar këtu qëmtoi në zanore të thjeshta. Këndej del si korolar, që të gjitha diftongjet e sotme janë sekundare; ato janë përfutur në faza të ndryshme të periodës postetnike të gjuhës pjesërisht nga segmentimi i një zanoreje, pjesërisht nga ndeshja e dy zanoreve, respektivisht e një zanoreje me një gjysmëzanore. Ky proces i dyfishtë i zhdukjes së diftongjeve të lashta dhe i formimit të diftongjeve të reja, aspektet e të cilit janë në një lidhje fonologjike midis tyre, pas mendimit tim përbën një nga tiparet fonetike konstitutive të shqipes. Përsa i përket ndërkaq mënyrës si reflektohen diftongjet e veçanta indoeuropiane në këtë gjuhë, aty ka mjaft pasiguri mendimesh. Ndërsa teza që diftongjet me komponent të parë të gjatë (diftongjet e gjata), ashtu si dhe në disa të tjera gjuhë indoeuropiane, kanë dhënë po atë gjë që kanë dhënë zanoret e gjata përkatëse, duke u zhdukur pra që heret i dyti element i tyre që konsistonte në një zanore të shkurtër (ose në një gjysmëzanore), gjan të jetë mjaft afër mendsh, dhe ndërsa kjo vlen edhe për diftongjet më *-u au eu*, të cilat kanë dhënë respektivisht *a e*, puna e mënyrës si pasqyrohen diftongjet më *-i oi e ci* paraqitet më problematike. Që ato u poqën së pari në *ai*, ashtu si dhe zanoret përgjegjëse *o e a* në *a*, kjo është gjë e pranueshme, vetëm se reflektimi i kësaj *ai* me *e*, i cili pranohet nga shumëkush. paraqitet mjaft i dyshimtë. Nga fjalët që jep Gustav Meyer si shëmbëj për një reflektim të tillë, *bē, degē, dele, derr, glepē, hie hē, hekur, ledh* «lym», *ngē, petk, rreth, shteg, venē verē, meje teje, gjalmē* nga një \**gjelmē*<sup>8</sup>, për një reflektim *oi*: *ai*: *e* pas mendimit tim vetëm dy vijnë përnjëmend në vështrim. *shteg* dhe *venē verē*. Të tjerat përmbajnë në thelb një tjetër zanore, kështu *dele* me *rreth* e pas gjase edhe me *derr* e me *degē* një *a* që pësoi metafoni në *e* përbrenda shumësit, *ngē* është *ngae*, po ashtu sic është *vesē voesē, glepē* i përket *lapërdhi-së, ledh* foljes *lyej, hekur* është gr. *ἀγρυφα* «spirancë», *gjalmē* është e afër me lat. *glomus* «lëmsh» etj. Pozitivisht për një zhvillim indoeur. *oi e ai*: shq. *a*, zhvillim që do të ishte paralel me atë të *au* në *a*, jep dëshmi fjala *glaj gjaj gjas, glarē i jati* «krejt i ati»: got. *galeiks* «i barabartë», angl. *like*, gjerm. *gleich* «baras me, i barabartë (*gleich einem Adler* «si një shqiponjë»), lit. *lygus* prus. e vj. *poligu* «barabar, gjithashtu» etj., baza e fjalës së shqipes një \**ga-laig-tiō* cse \**ga-laig-niō*, e cila oëndron në raport apofoinie me fjalën e gjuhëve gjermanike. Një tjetër shëmbëll është *āj ēnj ēnjt*,

7) Khs. për këto që shtiellohen këtu vrejtitet tona «Buletin për shkenc. shoqërore» XI (1957) Nr. II (IV) 207 vv., *Meshari i Gjon Buzukut*, I 65 vv.

8) Alb. *Studien* III 89 § 139.

*ajun* «ënjtur», bashkë me *prëj* e *prehem*, e cila më fort se me ind. e vj. *ániti* «merr frymë», gr. *ἀνεμος* «frymë, erë», lat. *animus* etj., afrohet me arm. *aitnum* «ënjtem», me gr. *οἰδῶ* «ënjtem, fryhem» *οἶδος* «lungë», lat. *aemidus* «tumidus, inflatus», gjerm. *Eiter* «qelb-i» etj., duke qenë refleksi i një indoeur. \**oid-* «ënjtem»; me *áj* lidhen edhe *end* «pështyn (miza) mishin» e *práj* «infektoj» *prâhem* «infektohem». Një tjetër dëshmi e ndërrimit *oi: ai: a* është emërorja e kallëzorja e mashkullores shumë të përmrit dëftor e vetor *ta* të *këta, ata*, sipas Pedersenit (KZ 36, 315) prej indoeur. *toi*. Këto rasa tregojnë që çështja e rregullimit të diftongjeve *oi* e *ai* në gjuhën shqipe mbetet e hapët<sup>9</sup>. Në këtë çështje unë largohem nga Pedersenit, sipas të cilit (në vendin e cituar) në trup fjale indoeur. *-oi-* *-ai-* në këtë gjuhë ka dhënë *e*, nga Hampi<sup>10</sup>, i cili edhe ky shpreh një mendim të afër me këtë, nga Pisani<sup>11</sup>, sipas të cilit *oi* edhe *ai* nuk u shkrinë në një në gjuhën shqipe, po mbetet të dalluara në reflekset e tyre, ajo duke dhënë *e*, kjo *a*; nga Georgievi<sup>12</sup>, sipas të cilit diftongu *ai* në rrokje të pathekse ka dhënë *a*, në të theksuarën *e*. Një ndërrim *ai: a* mendohet se e kanë pasur dhe ilirishtja e makedonishtja e vjetër.

3. Në lidhje me sonantet, teza e reflekseve të *r-së* silabike (*r*), e cila postulohet përgjithësisht si e tillë, edhe pas trajtimit të gjertanishëm të saj<sup>13</sup>, kërkon t'i shtrohet një gjurmimi të ri. Nga këto reflekse, *ri* si një zhvillim kryesor, antekonsonantik, e në pajtim të veçantë me keltishten, mua më duket po aq i dyshimtë sa edhe St. E. Mannit (Language 26, 388). Nga shembëjt që sillen në vërtetim të një zhvillimi të tillë, fjala *dritë*, të cilën e vënë në afrim me ind. e vj. *dadárśa* «kam parë» gr. *δέπρωμαι* «shikoj» etj., si një formim rime me *ditë*, mund të ketë pësuar ndikim nga ana e kësaj; *krimb*: ind. e vj. *kṛmi-*, lit. *kirmis*, irl. e vj. *cruim* etj. ka përbri vetes *karrém-in*; *brimë* «birë» është një postverbal i *brij brej*, sikundër është *bimë* një postverbal i *bij* «mbij». *frymë* i *fryj* etj.; *grij, ngrij, shtrij* e të tjera si këto mund të jenë formime foljore më *-inj, -ij*; pranë *trishë-s* «triskull; pipth, kalem, fidan» ka edhe *tresh* «pipth i njomë lisi, trishë», *tresh ullinë*. Mbi këto të dhëna edhe kjo çështje duhet të shikohet si e papërfunduar<sup>14</sup>.

4. Nga fusha e konsonantizmit të shqipes dihet se një nga kapitujt më të vështirë është problemi i guturaleve, dhe aty sidomos çështja e mënyrës së trajtimit të palataleveve indoeuropiane. Dihet se këtu dy teza qëndrojnë përballë njëra-tjetrës. Më njërën anë është rregulla e Gustav Meyerit që «Kështu pra në gjuhën shqipe *k*-ja indoeuropiane përfaqësohet me *s* dhe *ð* (*th*), *g*-ja dhe *g'h*-ja, të cilat janë pjekur e bërë një, përfaqësohen me *z*, *ð* (*dh*) e *d*. Ky trajtim i këtyre tingujve na kujton menjëherë zëvendësimin e *k'-së, g'-së, g'h-së* në degën persiane të iranishtes. Për *k'* persishtja e vjetër ka *s* dhe *ð*, për *g' g'h* ka *z* dhe *d'*»; më anën tjetër ajo e Pedersenit, që *k'* e *g' g'h* indoeuropiane përfaqësohen në shqipen pikësëpari me *ð* (*th*) e *ð* (*dh*), ku *dh* në ballë të fjalës kthehet

9) Khs. autorin BUST SSS XV Nr. 4, f. 127v., XVI Nr. 3, f. 80vv.

10) *Romance Philology* XII Nr. 2, f. 148.

11) *Saggi di linguistica storica* 99v.

12) *Introduzione alla storia delle lingue indoeuropee* 159 shën. 52.

13) G. Meyer, *Alb. Studien* III 78 v., Pedersen KZ 33, 541 e *Kelt. Gram.* I 42 v., Brugmann *Grundriss* I<sup>2</sup> 465, Jokl *Die Sprache* IX/2 120 vv.

14) Autori *Lingua Posnaniensis* VIII 97 v., BUST SSS XV Nr. 3 f. 52 v., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 114 v., *Scruti linguistici in onore di V. Pisani* I 184 v.

në *d*, po në sandhi mundet edhe të ruhet<sup>15</sup>. Për efektet e sandhit në gjuhën shqipe khs. W. Cimochofskin, Recherches sur l'histoire du sandhi dans la langue albanaise. *Lingua Posnaniensis* II 220-255. Kështu pra sipas të dyja tezave e pas mendimit të përgjithshëm kemi p.sh. *bathë*: gr. φαχή «thjerr», *dimër*, *dimën*; gr. χειμών, sllav. e vj. kishtare *zima*, *lidh*: lat. *ligare*, *dhëmb dhamb*: gr. γόμφος «kunj, gozhdë, dhëmb», sllav. e vj. kishtare *zobъ* «dhëmb», mirpo pas G. Meyerit ndër të tjera edhe *vis* «vend»: gr. οἶκος «shtëpi, banesë» lat. *vicus* «grup shtëpish, lagje, katund» sllav. e vj. kishtare *vъsb* «katund, truall», *nesër*: got. *nēhva* «afër», *sulem*: sllav. e vj. kishtare *sъlati* «me nisë, me dërgue», *zet*: lat. *viginti* etj. Në kundërshtim me këtë, Pedersen (në vendin e cituar, f. 336) arrin në përfundim që ai numrin e dëshmimeve për *s* e *z* të shqipes prej palatalesh indoeuropiane e ka pakësuar në një shkallë të konsiderueshme. Në këtë si dhe në të tjera çështje të fonetikës, përjashtimet nga një ligj janë një indic që ose ky ligj nuk është i drejtë, ose interpretimet etimologjike lidhur me të nuk janë të drejta, e që gjithsesi këto përjashtime kanë nevojë të shpjegohen. Unë në pajtim me Pedersenin mendoj që palatalet kanë dhënë vetëm spirante interdentalë, që pra *k'* ka përfunduar në gjuhën shqipe në *th*, dhe *g' g'h* në *dh* e në *d*; po shkoj një hap më tej edhe thom, që ato fjalë të cilat përmbajnë një *s* ose *z*, nuk kanë të bëjnë aspak me palatalet. Nga fjalët e serisë së shurdhët, një *vis visi* m. kinse të afër me lat. *vicus* etj. nuk ka; me këtë fjalë puna qëndron fare ndryshe: në gjuhë ka vetëm një shumës *vise*, nëpër dialekte edhe *vëse*, e ky tjetër nuk është veçse shumësi i moçëm i *vend-it*, *vend vise vëse* ashtu si *shpend*: shumës *shpës*<sup>16</sup>; ndajfolja *nesër* në thelb është «në mëngjes heret, me natë», pra është *n esëll herë* «në kohën e të qenit esëll»; *sulem*, si e ka parë M. La Piana<sup>17</sup> edhe unë vetë, lidhet përbrenda gjuhës me *sjell* «bie, shpie, çoj; i bie, e qëlloj» etj. Përsa u përket rasave të serisë së zëshme, *z*-ja nistore, në shumicën e tyre, afërsisht ashtu si në greqishten, ka rrjedhur prej një *i*-je indoeuropiane, pra *-zet* në *njëzet*, *dyzet* nga një *\*ieug-t*, *\*ieuk-t*, me kuptim të parë «çift, çift dhjetsish»: gr. ζύγυμ mbrej; lidh, bashkoj» ζυγόν «zgjedhë» lat. *iugum* «zgjedhë» etj.; *-zet*, si një formim i shkallës së lartë, e krahasueshme për nga trajta me gr. ζευκτός «i vënë në zgjedhë, i mbretur; i bashkuar»; i *zi*, fem. *e zezë* e afër me lit. *juodas* «i zi»; *zëmër zamër* «pasdrekja, iqindia» e afër me gr. ἡμέρα «ditë» e arm. *aur* «ditë»: *zog* «shpend i vogël; i vogli i shtazës përgjithësisht», si refleksi i një baze *\*ieguo-* «i ri», fjalë e afër me gr. ἦβη «fuqi e të riut, moshë e fuqisë, djalëri», arm. *jağ* «zog i ri, zokth, i vogli i shtazës», pers. e re *zāq* «i vogli i shtazës»; *ziej* me gr. ζέω «ziej, valoj» etj.<sup>18</sup> Khs. tani dhe G. Uhlich<sup>19</sup>. Kjo mënyrë reflektimi ka një rëndësi të veçantë e që i kalon caqet e shqipes, sepse vërteton që ndërrimi i indoeur. *i-* në *z-* që mendohet për greqishten, ka një analogji edhe në një tjetër gjuhë indoeuropiane. Dihet se Pedersen ka menduar një ndërrim të tillë edhe për arm. *jer* (shqiptuar *dzer*) «juaj», dhe ka shumë mundësi që edhe armenishtja me fjalën e saj *jağ* (shqiptuar *dzag*) «zog i ri, zokth,

15) Alb. Studien III 19 § 36. — KZ 36. 305 vv.

16) Autori, *Lingua Posnaniensis* VII 145 vv., VIII 120 vv., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 1 vv., 152 vv.

17) *Studi linguistici albanesi*, *Varia* f. 26.

18) Autori, Buletin për shkenc. shoq. 1952, Nr. 3, f. 37 vv., *Zeitschrift für Phonetik und allgemeine Sprachwissenschaft* IX (1956) 203 vv.

19) *Wissenschaftliche Zeitschrift der Humboldt-Universität zu Berlin, Gesellschafts- u. Sprachwiss. Reihe* Jgg. XVIII (1969) Heft 2 f. 330.

i vogli i shtazës» merr pjesë në barazimin gr. ἦβη: shq. *zog* që u dha më sipër (khs. për atë dhe G. Meyerin Alb. Studien III 18, Pedersenin KZ 36, 338), duke u vërtetuar kështu edhe një tjetër shembëll me *dz-* i armenishtes si refleksi i një *i-*je indoeuropiane. Në qoftë se është i drejtë mendimi i Pedersenit edhe imi, atëhere ky zhvillim fonetik ka përfshirë tri gjuhë indoeuropiane, të cilat paraqesin edhe disa të tjera izoglosa të shënueshme midis tyre. Në lidhje me greqishten e me shqipen do shtuar në këtë mes, që një reflektim dyfish si në atë gjuhën e parë, ζ : h (Ζυγόν : ἦπαρ), na shfaqet dhe në këtë të dytën, veçse në një tjetër mënyrë, më një anë, si u tha, si z, më anë tjetër, pas mendimit të përgjithshëm, me *gj*, *gjesh*, *ngjesh* «lidh mesin me një brez, vë armët në mes»: avest: *yásta-* «ngjeshur», sll. e vj. kishtare *pojasъ* «brez», gr. ζωστός «ngjeshur (brezi)» etj. Në këtë mes ndërkaq duhet vërtetuar që një tjetër refleksi shqiptar i indoeur. *i*, i vënë re nga ana e Gustav Meyerit (Alb. Studien III 39), d.m.th. *j*, në fjalën *ju* si dhe në *-jo* te *ajo* e *këjo*, sikundër e vuri re Pedersenin, Festschrift til V. Thomsen 246 vv. — dhe e kam shtjelluar unë vetë në vendin e cituar më sipër — bie poshtë: do shtuar se bien poshtë gjithashtu dhe tre nga katër shembëjt me *gj-* që përfshin rregulla e G. Meyerit, e pikërisht *gjesh ngjesh* «mbruj (bukën), shtyp, rrasallit (fijet e leshit, për qeleshe)», *gjër* «supë» dhe *ngjëroj* «kërkoj në gojë një gjellë ose një pije». Ndërkaq ndrimi *i- : gj-* si i tillë mbetet bindës. Në të mirë të tij, përveç barazimit *gjesh ngjesh* (brezin, armët): gr. ζωστός që u dha më sipër, flet edhe kjo, që edhe lat. *i* ka dhënë në ballë fjale *gj* në gjuhën shqipe, *iudicium*: *gjyq*, *iurare*: *përgjërohem*. Në lidhje me greqishten e me shqipen do shtuar ndërkaq edhe kjo vërtetje, që rasat me z të shqipes e të greqishtes nuk pihen çdo herë; khs. më një anë *zie*: ζέω -zet: ζευκτός, po më anë tjetër *zog*: ἦβη, e më një anë tjetër edhe *gjesh ngjesh*: ζωστός. Edhe që këtej shihet se te ndërzimi *i : z-* që u shtjellua këtu, në të tria (ose të dyja) gjuhët që vijnë në vështrim aty, pas gjithë gjasës nuk kemi të bëjmë me një inovacion të përbashkët, po me një spontan, të pavarur dhe shumë-shumë paralel, me një zhvillim fonetik të periorodës vetiake, postetnike në secilën nga këto gjuhë.

Në këto rrethana z-së së sotme të shqipes do t'i njihen së paku gjashtë vlera etimologjike, nga të cilat e para dhe e treta paraqiten vetëm në ballë fjale: 1. z- nga një *i-* indoeuropiane: *zet*, *ziej* etj. — 2. z nga një *gu(h)* indoeuropiane përpara një zanoreje të çelët, *zjarm*, ind. e vj. *gharmá-s* «nxehtësi» arm. *jerm* «i ngrohët» gr. θερμός etj.; *ndez*, në lidhje apofonie me *djeg*, ind. e vj. *dáhati* «djeg» lit. *degù* «digjem, ndez» gr. τέφρα «hi» lat. *foveo* «ngroh, nxe», irl. *daig* «zjarr» etj. — 3. z- nga *xhv-* *zv-* zë *zá* «zëri», sllav. e vj. kishtare *zvонъ* «tingull, tingëllim», për *zv-* që dha z-khs. edhe Gustav Meyerin Alb. Studien III 39 § 68. — 4. z- nga *dj* në pozicion pas edhe para theksit, si s nga *tj*, *máz* mëz pranë foljeve *mëzej* dhe *mënd*, *gaz* nga lat. *gaudium*, *mriz* nga *meridies*, *zanë zërë* nga *Diana*<sup>20</sup>. — 5. z nga një s e lashtë ndërzanore që u bë qëmoti e zëshme, në rasi të tilla si *gëzof*, që shkon me gr. γανδαπής lat. *gausape*<sup>21</sup>. — 6. — z me rrugë asimilimi në pozicion antekonsonantik. *zgjebe* prej lat. *scabies*, *zverk*, *zgjoj* pranë *sqoj*. Në disa huazime latine ky tingull ndonjëherë i përket gjuhës dhënëse, latinishtes, si në *parriz* nga *paradisus*<sup>22</sup>; khs. edhe *zgjebe*

20) Khs. për këtë G. Meyerin Alb. Studien III 28 § 50, Meyer-Lübken Gröbers Grundriss der romanischen Philologie I<sup>2</sup> 1052, Joklin te Walde-Hofmann I 30.

21) Për këtë fjalë N. Jokl te Walde-Hofmann II 585.

22) Ndryshe mendon R: Helbig, Die italien. Elemente im Alb., X. Jahresbericht d. Rum. Instituts Leipzig 74.

nga lat. *scabies* që sapo u zu ngoje, edhe rum. *zgaibā* abruc. *zgabbye*, friul. *zgabye*, te Meyer-Lübke REW 7634. Në cilën periudë të shqipes koinciduan reflekset e indoeur. *i* dhe *gu*<sup>(h)</sup> si edhe ato të *zv-* e të *dī-sē*, duke u pjekur të gjitha në *z-në* e sotme ose në shkallën e përparme të saj, kjo pyetje mbetet pa përgjegje. Pas Pedersenit (vendi i cituar, f. 340) si tingulli i sotëm *z* që rrjedh nga labiovelari *gu*<sup>(h)</sup>, si *z-ja* që buron nga *dī*, janë arritur në periudën e shqipes III (koha historike). M'anë tjetër disa të tjerë dijetarë, si Treimeri, Barić, Jokli, Vasmeri kanë arritur në përfundimin që si shkallë e mëparme e sibilantit *s* që i përgjigjet *z-së*, do menduar një afrikatë e gjashme me *ç-në*, khs. *sorrë*: rum. *cioarā*, *porosit* nga sllav. *poročiti*<sup>23</sup>. Analogjikisht edhe për *z-në* e sotme si parashkallë e pandërmjeme mund të mendohet një afrikatë e zëshme *dz* (*x*) ose *dž* (*xh*).

Pasi sqarohet kështu çështja e palataleve me anë të këtij revizioni të materialit dhe të përjashtimit të postdentaleve *s* e *z*, prapsepapë problemi i guturaleve në gjuhën shqipe si i tillë, edhe pas monografisë me këtë titull të Pedersenit, nuk ka marrë një zgjidhje përfundimtare. Pa e shqyrtuar këtë problem të vështirë, ashtu si do të meritonte, në tërësinë e tij dhe në çështjet e shuma që kanë lidhje me të, dhe pa mundur të përmend as edhe emrat nga gjithë ajo literaturë që është grumbulluar që prej vitit 1900 kur u botua monografia në fjalë, në lidhje me ç'u shtjellua këtu nuk dua të rri pa prekur disa pika, të cilat më duket të jenë me rëndësi në punën e gjykimit të guturaleve të shqipes si dhe të vendit që zë shqipja në rrethin e gjuhëve motra.

Së pari labiovelaret. Asibilimi i këtyre tingujve në pozicion para një zanoreje të çelët (*sjell*: ind. e vj. *cārati* «lëviz, sillet, shtekton, kullot» gr. *πέλομαι* «jam në lëvizje, sillem» lat. *colo* «lëvroj, punoj, kujdesem, nderoj» etj.; *zjarm*: gr. *θεριός* lat. *formus* «i ngrohët» etj.; *ndez* pranë *djeg*: lit. *degù* «digjem, ndez» etj.; sh. më lart) nuk paraqet në thelb ndonjë gjë më vete e të veçantë. Ky asibilim është i krahasueshëm me dentalizimin e labiovelareve në greqishten në të njëjtin pozicion (*τις, δελφός* «ani i fëmijës»). Këtë gjë e kam pasur të qartë prej vjetësh. kur pashë më vonë me kënaqësi që e paskish vënë re më parë Pedersenin (f. 306) dhe në këto kohë e fundit edhe Solta (IF 70, 286), të cilët ndërkaq që të dy me formulimin e tyre «Me trajtimin e ndryshëm të velareve të thjeshta dhe të labiovelareve shqipja pajton me greqishten» e shtrijnë këtë pajtim dhe te të ashtuquajturat velare të thjeshta (të mirëfillta). Te kjo çështje e fundit do të kthehem sakaq, po më parë duhet të përmend këtu për plotësim dhe dy pika të tjera. Bonfante tërheq vëmendjen në faktin që greqishtja me palatalizimin e labiovelareve përpara një zanoreje të çelët afrohet me gjuhët satem (indoeuropiane lindore), «... le grec, qui, du point de vue des labio-velaries (palatalisation devant \*č, ʃ), doit être considéré comme une langue satem»<sup>24</sup>. Dhe Pisani me Evangelistin vënë në dukje që edhe në armenishten e në tokarishten labiovelaret dhe velaret e thjeshta në një pozicion të tillë dallohen nga njëri-tjetri<sup>25</sup>. Mbi këto dëshmi Solta arrin në përfundimin që nga kjo anë shqipen, greqishten, armenishten, tokarishten do të bëjmë mirë të mos i ndajmë. Për shqipen më me rëndësi do

23) Khs. autorin Rev. Shk. e Inst. Pedag. dyvj. Shkodër, 1 (1964), 18 shën. 37, *Zeitschrift für Balkanologie* II 21 v., shën. 37, me literaturën e mëparme për ndrimin *ç:s* (Treimer, Barić, Vasmer, Jokl). Shto tani edhe Jokl, *Die Sprache* X 125 v.

24) *Mélanges linguistiques offerts à M. H. Pedersen* 24.

25) Khs. Pisanin, *Saggi di linguistica storica* 101 v., Soltan f. 277 v. Një qëndrim të afër me këtë mban sipas Bonfantes edhe likishtja, sh. Pisanin në vendin e cituar

të ishte kjo, që, sikundër mendon O. Haasi (Messapische Studien 185), në mesapishten indoeur. *ku* përpara një *i*-je ka dhënë *ti / θi*, një zhvillim për të cilin sipas këtij dijetari shembëj vërtetues janë vetëm trajtat e përmurit të pakufishëm *tis θis ti* = gr. *τις*, lat. *quis* etj.

Përsa i përket tani numrit të guturalevet indoeuropiane dhe reflektimit të tyre në gjuhën shqipe, dihet se Pedersenit si më parë si më vonë<sup>26</sup> i mbahet teorisë së tri serive dhe se njëkohësisht qëndron në këtë mendim, që shqipja është e vetmja gjuhë indoeuropiane që të tri seritë guturale i ruan të veçuara në reflektet e tyre: pra më një anë *bathë*, *lidh* etj. (palatale, sh. më lart f. 82), *sjell*, *zjarm* (labiovelare, sh. më lart. f. 84), *qeth*, *gjej* etj. (velare të thjeshta, sh. më poshtë). Në kundërshtim me këtë, prej kohësh ka dhe një tezë për dy seri guturalesh në indoeuropianishten. Të dyja këto teza kanë, sikundër dihet, dhe mbrojtësit dhe kundërshtarët e tyre, dhe edhe në lidhje me qëndrimin e shqipes dijetarët janë ndarë, si të thuash, në dy lagje. Dihet që E. Hermann sidomos është ngritur kundra, duke e arësytuar kundërshtimin e tij edhe në hollësira<sup>27</sup>. Duke paravenduar si për të tjerat gjuhë satem (lindore), ashtu edhe për shqipen dy seri guturalesh, një të celët, që përfshin palatalet, dhe një tjetër të mbyllët, që rrok velaret e labiovelaret, ai tezën e Pedersenit, «që shqipja të ashtuquajturën seri të labiovelareve e ka zhvilluar në mënyra të ndryshme sipas timbrit të zanores ndjekëse», e quan të drejtë; m'anë tjetër përkundrazi të njëmbëdhjetë shembëjt që duan të vërtetojnë ruajtjen e velareve të thjeshta në gjuhën shqipe në pozicion para zanoreve palatale, pra një trajtim të kësaj serie guturale të ndryshëm nga ai i labiovelareve përpara zanoreve të tilla, ai i gjen të gjykuar gabim, sepse sipas tij fjalët *gjej*, *dergjem*, *ergjöz* «morrat e vegjël që sapo kanë dalë nga thëriat», *helq* «heq», *keq*, *qell*, *qeth* që të gjitha mund të jenë formime analogjike. Në dytësimin (replikën) e tij në vendin e cituar Pedersenit vërtet pranon që ndonjëri ose tjetri nga këta shembëj mund të merret si formim analogjik ose dhe të hidhet poshtë si i gabuar, po përndryshe i mbahet mendimit të tij kryekrejt.

Me një shqyrtim të mësenjchershëm të materialit të ditur e me një afrim e marrje parasysh si duhet të materialit të zbuluar më vonë, unë prej vjetësh kam arritur në përfundimin që mendimi i reflektimit të labiovelareve, para një zanoreje të celët, me anë sibilantesh (*sjell*, *zjarm*), është me vend. Këtë rregull besoj ta kem vërtetuar si të drejtë edhe me dy shembëj të tjerë, me *darsmë* pranë *darkë*: gr. *δάρπον* «darkë», dhe me *vdes* pranë *vdekur* e *vdekje*: ags. *deorc* «i mbyllët» angl. *dark* «i errët, i mbyllët». Më anë tjetër mendimi i një trajtimi të ndryshëm nga ky i të ashtuquajturave velare të thjeshta po në atë pozicion, pra me tinguj të sotëm palatalë si në rasat *gjej*, *qeth* etj. që u dhanë më sipër e që s'i njej për të drejta E. Hermannit, ky mendim më duket se ka nevojë për një revizion. Metafonia *a*: *e*, e cila, sikundër e kam shtjelluar gjer' e gjatë më një vend tjetër<sup>28</sup>, me zhvillimin e saj më tej në *a*: *e*: *i*, e përshkon mbarë sistemin morfologjik e leksikor të shqipes në periodën e saj historike dhe si e tillë nuk është njohur e vlerësuar sa duhet në rëndësinë e saj, duhet medoemos të merret parasysh edhe në shqyrtimin e fjalëve që u çekën më lart. Kështu, nga formimet nominale, *ergjöz* *ergjis* është një

26) Edhe në IF 22, 353 v.

27) KZ 41, 46 vv.

28) *Lingua Posnaniensis* VIII, 111 vv., 122 vv., shqip në *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* 133 vv., 147 vv., aty me disa plotësime.

inovacion i qartë, një shumës i mirëfilltë, njëjësi i të cilit, që doli në shesh më vonë, është *argull* (shumësi *arguj* dhe *ergjes ergjës*), në Kalabri *arg* e *argur* shumësi *ergje ergjes* «piccolo pidocchio; uovo di pidocchio»<sup>29</sup>. Unë ashtu edhe te *keq* jam i prirur të gjej një shumës, me burim prej gr. *κακός*. Në fushë të fjalëformimit, pranë *ah-ut* ka *ehull*; pranë *ambël*, kjo pas mendimit tim *a-mel* prej indoeur. *mel-* shq. *mjaltë*, ka *e-sëll: sillë* «buka e mëngjesit», kjo pas Pedersenit nga një *\*a-sëll*. Po ky raport na del edhe te folja. Edhe aty rruga ka shkuar nga *a* në *e*, jo anasjelltas, edhe aty format analogjike me *e* kanë shtyrë mënjane format origjinale më *a*. Kështu pranë *derdh* ekziston pjesorja *dárdhunë* që paraqitet e dëshmuar më heret, pranë *desha* pjesorja *dashun dashur*, pranë *shkel* ka *shkal* «shkel» (shajakun) në dërstilë; sipas bestytisë. shuplak» (: «shkel»); dhe është shenjë e një metode të metë, kur në shpjegimin e foljes *erdha: ardhun ardhur*, për bazë, sikundër ndodh shpeshherë edhe sot, merret forma e parë, pa vënë re e pa çmuar sa duhet që te këto folje forma origjinale ruhet kudo te pjesorja. Po të shikohen që këndeja fjalët *dergjem, gjej, helq, qeth*, për të cilat thuhet se vërtetojnë mënyrën e trajtimit të velerëve të thjeshta para zanoreve të çelëta, gjendja paraqitet si vijon. *dergjem* «rri ratë në shtrat, kur jam sëmurë», jo «jam sëmurë», vërtet se pranë saj ka *dergjë* «sëmundje e gjatë e frymorëve dhe e bimëve, tuberkuloz, verem, kollë e keqe», po ka m'anë tjetër edhe *dirgjem* e *zdirgjem* «zbrës, ulem nga lart poshtë, varem poshtë; lind», *me djergë* «me pjellë» bashkë me *djergsore* «lehonë, llahusë», *me zdjergë* «calare, discendere»; me të drejtë prandaj G. Meyeri i bashkoi dy foljet, dhe pa të drejtë Pedersenit (vendi i cituar, f. 286 v. e 329) i ndau nga njëra-tjetra. Kuptimi i mirëfilltë i kësaj fjale është kryekrejet «zbrës», e prej këndeja dhe «jam ratë» edhe «pjell, lind»; khs. prej Buzukut<sup>30</sup> *E si dirgjetë shiu e bdora n qiellat* «Et quomodo descendit imber et nix de caelo», pranë *E ndë ta dergjë e madhe shumicë n së sëmunësh* «In his iacebat multitudo magna languentium»; për kuptimin «lind» khs. gjerm. *niederkommen* «lind», fjalë për fjalë «zbrës, vij poshtë». Forma bazë e fjalës së shqipes është një *\*darg-*, e cila me metaforë të zanores *e* me palatalizim të guturalit arriti në *dergj-*; *dergj* qëndron ndaj *djerg* të geg. veriore ashtu si *heq* ndaj geg. veriore *hjek*. Për punë të kuptimit vështirë që *dergjem* të jetë e grupit lit. *sergu* «jam sëmurë, lëngoja», gjerm. *Sorge* «kujdes, gajle» irl. e vj. *serg* «sëmundje» ind. e vj. *sūrksati* «përkujdesem për diçka», ose e grupit rus. *sudoroga* «ngercë» *deržatъ* «me mbajtë» gjerm. *zergen* «me gërگا» etj., si kanë menduar alternativisht gjer më sot. Mbase e afër me grupin sllav rus. *doroga* «udhë, rrugë» serbokr. *draga* «luginë», si «ultinë», ose me rus. *nadoroga* «mot i keq, shtërgatë» lit. *dārga* «mot i keq me shi» etj., në qoftë se kuptimi i hershëm i këtyre është «reshme». — Ashtu si te *dergjem*, edhe të *gjej* forma e sotme bashkë me kuptimin e sotëm pas gjithë gjendjes nuk janë ato të kryehershmet, prandaj edhe lidhja me gr. *χαυδάω* «rrok, zë» lat. *prehendo* «rrok, kap» got. *bigitan* «me marrë, me gjetë» etj. që është menduar gjer sot, vështirë që të jetë e drejtë. Si *gjel* që rrjedh nga lat. *gallus*, e *gjeth* nga një *\*gath*, *gjedh* nga një *\*gadh* që është veçanërisht e afër me sllav. *govedo* «gjedh», ashtu pas gjithë gjasësh edhe *gjej* rrjedh nga një *\*ganj* *\*ganiō*, e cila si refleksi i një *\*gadniō*

29) Për fjalën e Kalabrisë Giordano, *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë* — *Dizionario degli Albanesi d'Italia*, Bari 1963, f. 13, 14.

30) LXI/2 = LXXI/2, Isaia 55, 10; XLV/2, Gjoni 5, 3.

është e afër me grupin sllavo-baltik serbckr. *dogòditi* «me i ra më të» *dogòditi se* «me ndodhë» *zgòditi* «me takue, me ndeshë», bullg. *ugodъ* se «ndodh» *pogodъ* «godit në shenj, qëlloj», çek. *hoditi* «me hudhë», leton. *goditis* «me ndeshë, me pritë» *gaditië*s «me u ndodhë aty, me u gjetë, me u dukë, me ndodhë». Me këtë etimologji pajtojnë dhe përdorimet e fjalës, kuptimi bazë i së cilës pas gjithë gjasësh është «godit, qëlloj». Sepse *gjej* përveç se «gjej» do të thotë edhe «takoj në shtëpi, pjek, takoj, ndesh në udhë», «vij, ja mbërij» (për një letër)<sup>31</sup>, e *gjeç nga Perëndia* «que Dieu t'en punisse», kështu që edhe shprehjet analoge të gjuhëve të tjera ballkanike<sup>32</sup> mund të kenë buruar prej shqipes. — Afërsisht ashtu si të *dergjem* e të *gjej*, edhe të *helq*, *qell* edhe *qeth* guturali palatal i sotmi është përfutur në periodën postetnike të shqipes me rrugë analogjike. Pranë *helq* ka një *hjek* dialektore që u zu ngoje më sipër, e pranë kësaj ekziston edhe *hiki iki* e mbarë gjuhës, kjo në thelb «heq tutje», të dyja trajta me gutural të ruajtur e të papalatalizuar. Kështu edhe pranë *qell* ka *kall*. Përsa i përket foljes *qeth*, të cilën që prej Gustav Meyerit e këtej e afrojnë të gjithë me lit. *kertù* «pres, rrëzoj» lat *cortex* «lëkurë, lëvore» gr. *κέρατος* «tallës» etj., ka të drejtë njeriu të pyesë pse të jetë zhdukur këtu tingulli *r* përpara spirantit interdental, e të mos jetë zhdukur dhe të *derdh* që u përmenë më lart, si dhe në gjithë rasat e tjera, si *gardh*, *mardh*, *pjerdh* etj. Në qoftë se do të thotë njeri që kjo zhdukje u krye vetëm para spirantit të shurdhët e jo edhe para të zëshmit, një gjë e tillë në parim është e mundur, veçse në të vërtetë fjalët që sjell Gustav Meyerit (Alb. Studien III f. 40) në vërtetim të një zhdukjeje të tillë, të gjitha si të padrejta që janë bien poshtë, dhe një shembëll i vetëm, siç është *qeth*, nuk mjafton atëhere për të vërtetuar një rregull fonetike. Sikundër që *qell* përbrenda gjuhës si trajtë sekundare shkon me *kall*, e *qelb* me *kalb*, ashtu edhe *qeth* pas gjithë gjasësh është vazhdimi metafonik e i palatalizuar i një \**kath*, trajta nominale e së cilës duket se na ruhet të *kadhë*, *kadhëm* «një farë kize me bisht të gjatë, me të cilën shkadhysin ferrat e drizat».

Këto besoj se mjaftojnë për të treguar që çështja e mënyrës së zhvillimit të guturaleveve indoeuropiane në gjuhën shqipe ka nevojë për një revizion në themel, sidomos përse i përket përfaqësimit të të ashtuquajturave velare të thjeshta indoeuropiane. Kjo anë e çështjes është aq më problematike, kur të kemi parasysh faktin e pavënë re sa duhet, që në gjuhën shqipe palatalizimi para zanoreve të çelëta ka rrokur gjithë okluzivet guturale pa dallim, pra pavarësisht nga karakteri origjinal, i kryehershem i tyre. Ai është zbatuar sidomos edhe tek ato guturale, të cilat i bien të ardhura përgjithësisht prej labiovelaresh indoeuropiane. Kështu, bie fjala, shumësi i *ujk-ut* bën *ujq*, folja *djeg*, që është e afër me lit. *degù* «digjem, ndez», gr. *τέφρα* «hi» etj. dhe që përbri vetes ka edhe *ndez*, në aorist p.sh. bën *dogja*, *dogje*, *dogj(i)*, në të tashmen e mediopasivit *digjem* etj.; gjithashtu edhe të *vdes* e *vdekur*, të cilat me *k*: *s*-në e tyre çojnë të një labiovelar, aorist bën *vdiaq* *vdiaqe* *vdiaq*; folja *kall* që u zu ngoje më sipër, ka pranë vetes më një anë *qell*, më anë tjetër *sjell*, e cila dihet se afrohet me lat. *colo* gr. *πέλωμαι* «jam në lëvizje, sillem» etj.; pranë *gacë* «thëngjill i ndezur; shkëndijë» *gacullinë* «xixëllojë» *gurgác* «gur shkrepës, strall», e cila sipas Joklit,<sup>33</sup> si refleksi i një \**garcë*, hyn në rrënjën in-

31) Pedersen, Alb. *Texte mit Glossar* 129 v.

32) Te P. Papahagi, XIV. Jahresbericht d. Rum. Instituts Leipzig 128 Nr. 95.

33) Studien z. alb. *Etymologie und Wortbildung* 21, *Zeitschrift für Ortsnamenforschung* X 186 v.

doeur. \**gʷher-* \**gʷhor* ku bën pjesë dhe *zjarm*, ka edhe *gjirmë, gjermë* «trolli ku ndizet zjarmi, vatër»; ndryshe, për mua në mënyrë jo bindëse, i shpjegon këto rasa Pedersen (në vendin e cituar, f. 328 v.), me anë të një restitucioni.

Duke i rrokur këto me një vështrim përmbledhës, shihet se palatali i sotëm i emrave si *ergjëz* e i foljevetë tilla si *dergjem, gjej, qell, qeth* etj. nuk arrin të paraqesë një vërtetim për ekzistencën e velareve të thjeshta indoeuropiane e për një reflektim të veçantë të tyre para zanoreve të çelëta në gjuhën shqipe. Këtu përkundrazi është e pamundur të mos vihet re një rregull fonetike. Ashtu si në disa të tjera gjuhë indoeuropiane, veçanërisht në gjuhët sllave, edhe në shqipen është kryer një palatalizim i dyfishtë para zanoreve të çelëta. I pari, e më i lashti, ka shndërruar të ashtuquajturat labiovelare në sibilante, *darkë: darsmë, djeg; ndez*. I dyti, më i voni, ka zbutuar në palatale gjithë guturalet: *kall: qell, kalb: qelb, vdes vdekur: vdiqa, djeg: digjem*. Aty hyjnë, sikundër u tha, edhe *dergjem, gjej, qeth, ergjëz* bashkë me rasiat e tjera që u përmendën më sipër.

Këto rrethana duhej të na bënin më të matur edhe në gjykimin e gjendjes gjuhësore të Gadishullit ballkanik të kohës antike. Kur te një gjuhë e gjallë siç është shqipja, materiali, sikundër u tregua këtu, interpretohet shpeshherë në mënyrë të padrejtë, shumë më i madh është një rrezik i tillë në punë të gjuhëve të vdekura, për të cilat më të shumtën nuk dihen as sistemi fonetik as kuptimet e fjalëve, rindërtohen këto shumë herë me lodra kombinimesh, dhe nga këto nxirren përmbyllje (konkluzione) largshkuese në lidhje me pozitën e tyre gjuhësore.

5. Nuk do të hyj këtu në çështjen e vështirë të reflekseve të grupeve s + gutural. Po vrej vetëm këtë, që fakti i konstatuar së pari prej Kamardës (I 71), që *h* ka dalë nga grupi *sk*, në rasa të tilla si *hurdhë hudhër*: gr. *σκόροδον* «hudhër» dhe në *h*-në fundore të disa foljeve si *njoh*: gr. *γινώσκω*, e cila rrjedh prej elementit inkoativ - *skō*, u formulua prej Joklit (IF 30, 192 vv.) në këtë mënyrë, që *sk* në pozicion para një zanoreje origjinalisht të mbyllët ka përfunduar në *h*, e para një të çelëte në ç: *hap-i: çap-i, i çalë* nga një \**skel-no-*, çel: lit. *skeliù* «çaj» *skiliù* «çel zarrin», çef mëçef *fsheh*: gr. *στέπας* «strehë» *σπετάζω* «mbuloj, strehoj, mbroj», çaj: ind. e vj. *skhadatē* «çan» etj. Duke i gjetur në thelb të drejta këto shpjegime fjalësh, mendoj me gjith'atë që trajta e vjetër e ç-së në këtë ndërrim fonetik është *sh*: Krahas me çel ka një *mbërshel mëshel* «mbyll» të mbarë shqipes, krahas me çef, mëçef ka *fsheh*, në shqipen e Italisë *shex*; pranë çaj ka *shaj* «fyej me fjalë të rënda; flas keq për një njeri; gjykoj një njeri, vërtetoj fajin e tij», khs. për kalimin kuptimor nga «çaj» në «gjykoj» gr. *κρίνω* «vecoj, dalloj, zgjedh, vendos. gjykoj» *κριτής* «gjykatës»: maked. e vjetër *σχοῖδος* «plak, arbitër»: gr. *σχίζω* «çaj, veçoj». Po ashtu dhe përbri i çalë është emri *shalë* «ana e brendshme e kofshës; pjesa e trupit që shkon nga rrëza e kofshës gjer poshtë te syri i këmbës», një fjalë që fort pa të drejtë e kanë hedhur në një thes me *shalë*-n e kalit, kjo prej lat. *sella*; i çalë shkon poashtu me *shalë* sikundër shkojnë gr. *σελλός* «shalështrembër» e *σκολιός* «i shtrembër; i rrem, tinzar» me *σέλος* «kofshë, shalë», këto të gjitha të afra me ato të shqipes; aty mbase hyn edhe arm. *szalem szalim* «pengohem, marr në thua, lëkundem, gaboj, mëkatëroj; bie poshtë, dështoj» *szal* «gabim, cen, mungesë; i metë, mangut, i pakët» *szalak* «që i merren këmbët (kur është i dehur)», të cilën që prej Hübschmannit e këtej bashkë me ind. e vj. *skhālatē* «merr në thua e rrëzohet, lëkundet, gabon» *skhalita-h* «që merr në thua, që gabon: i

mangët, i pakët», e marrin si refleks të një rrënje indoeuropiane të veçantë \**skhel-* «marr në thua, shkel keq», khs. Walde-Pokornyn II 599, po edhe Pokornyn I 929. Një tjetër *shalë*, po edhe kjo fjalë etimologjikisht e afër me këtë të shqipes që sapo çekëm këtu, dhe e përfaqësuar edhe në disa emra visesh e lumenjsh, na ruhet te *shalës* «një farë dheu» e te zgjerimi i tij *shalësinë* «tokë mashkullore, jo e gratshme», dhe ka lidhje afërie me lit. *skeliù skélti* «çaj» që u zu ngoje më sipër, me gr. *σάλλω* «gërryej, shatoj, gërmoj, mih», e kuptimisht sidomos me gjerm. *Scholle* «plis dheu». Nga toponomastika hyn aty pas gjithë gjasësh edhe emri i fisit e i krahnës *Shala* të Shqipërisë veriake, bashkë me emrin e *Shalë-s* në Kosovën lindore pranë Mitrovicës. Një tjetër dëshmi për *sk*: *sh* nga ajo anë është emri shqip i malit *Shar* (turq. *Şardagh*), trajta vendëse e *Scardus mons* të kohës antike (emër i afërm me lit. *skardūs* «i thikët»), i cili paraqet ndërrimin e grupit *sk* në *sh* të shqipes, në kundërshtim me sllav. *Skradin*, kjo prej *Scardona-s* së vjetër të Dalmacisë. Unë pra mendoj që një *sk* origjinale, në disa kushte që duan diktuar, në gjuhën shqipe ka çuar në *sh*, poashtu si në gjuhët romane e në një pjesë të gjuhëve gjermanike. Kështu unë edhe fjalën *shark* «gëlvozhë e gjelbër e arrës; mishi i disa pemëve me një bërthamë, si pjeshka e kumbulla» nuk e bie të ardhur (me Joklin IF 44, 23 v.) prej gr. së vj. *σάρξ σαρκός* «mish», te Teofrasti «mishi i pemëve». Pashkë me *shark* «lëkurë» në shprehjet *sharku i bollës, zhergë* e *zharg* «pelle che è deposta dal serpente in primavera; scorza d'albero» (Bashkimi), pra «lëkurë e gjarpërit; lëkurë e drurëve», me *zherku* «lëkurë e shtazës që shërben si rezonancë e lahutës», me grupin *shakull* «calik për të mbajtur bulmet, djathë, gjalpë a gjizë, petite outre», me *rrëshek rrëshiq* «lëkurë dhie për vaj, verë e bulmet; gjyruku i kovaçit», *shirk shirq shiq* «rrëshek, calik», si edhe me *shark* «zhgun leshi, i zi ose i bardhë, pa mëngë e me thekë, bërruc», si fjalë me kuptim të mirëfilltë «lëkurë» e si refleksin shqiptar të rrënjës indoeuropiane \**sker-* «pres», e afroji me irl. e vj. *scairt* «rjeta rreth zorrëve, diafragma; zemra: përbrendësat», gjerm. e lartë të vj. *skërm, skirm* «mburojë» (prej lëkurësh), rus. *skorá*, pol. *skóra* «lëkurë, lëkurë shtazësh» etj. Për hir të së drejtës duhet thënë që edhe Gustav Meyeri (f. 444) lidhi fjalën *i calë* me gr. *σκολιός*, çaj me gr. *σάζω* «gërric, çaj, hap, gdhend; lëshoj», duke e prurë ç-në në atë mes të dalur në ballë fjale nga një *sh-* e duke parë te kjo vetë refleksin e *sk'*-së indoeuropiane; khs. edhe shënimin e tij Alb. Studien III 60 v., ku ky dëshiron që të merret si një mendim i dorajdorsëm, po njëkohësisht ndërkaq çef e bie të ardhur me të drejtë nga *mshef* e *shef*.

Si për *sk*, ashtu dhe për grupin e anasjelltë *ks* nuk mundemi pa pranuar *sh* si reflektim të tij në gjuhën shqipe. Khs. për këtë fjalën *push*, kjo jo prej turq. *puş* «mbulues, mbulesë» (G. Meyer), po si refleks i një baze \**puk-* e afër kryekrejet me rus. *puch* «push», lit. *paustis* «aime shtazësh» *paustile* «push (i shtazëve)» etj.; *tresh* «pipth i njomë lisi, trishe» *tresh ullini, trishe* «triskull; pipth, kalem, fidan», pas mendimit tim — në kundërshtim me mendimet e gjertanishme — e afër me gr. *τρέχνος τέρχνος* «lumaqe, degë, gem», kjo nga një \**treksno*. Një ndërrim fonetik *ks*: *sh* ka qenë përsjatur edhe më parë, nga Gustav Meyeri e nga Brugmanni për trajtën foljore *pashë* e për *gjashtë*<sup>34</sup>, nga Kamarda (I 36, 76) dhe La Piana (Studi linguistici albanesi I 85) për *jashtë*: gr. *ἐπτός* «jashtë, përjashta», *jashtë* sipas Ribezzos (në një kumtim gojor) nga një \**eksto-*, e pas mendi-

34) Alb. Studien III 14. — Grundriss I<sup>2</sup> 566.

mit tim, si refleks i një baze \**ekst-*, drejtpërdrejt e afër me gr. ἐχθός «jashtë», kjo sipas Deeckes nga një \**eks-tos*, për Deecken sh. Schwyzer, Griechische Grammatik I 326, 630 shën. 3, Frisk I 478; te Barići e St. E. Manni edhe disa fjalë të tjera<sup>35</sup>, për shumicën e të cilave ndërkaq puna mbetet e pasigurtë. Një shqyrtim i ri i guturaleve në gjuhën shqipe duhet të përfshijë edhe grupet s + gutural dhe gutural + s. Në lidhje me këto khs. autorin, Lingua Posnaniensis VII 174 vv., VIII 97 v., Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe 46 vv., 114 v.

6. Në kundërshtim me dijen e gjertanishme, unë jam i mendimit që grupet e lashta *nt*, *nd* e *ng* në pozicion ndërzonor (intervokalik), pavarësisht nga vendi i theksit përbrenda fjalës, nëpërmes shkallës *nn* janë asimiluar në *n*, e cila nga puna e karakterit origjinalisht jo ndërzonor të saj nuk pësoi zhvillimin më tej në *r* (rotacizmin) të toskërishtes: *anë*, ind. e vj. *ántah* «fund, kufi, skanj», got. *andeis* gjerm. *Ende* «fund, mbarim», khs. *në të katër anët*: gjerm. *an allen vier Enden* «në të katër anët», jo si refleks i një baze \**ausnā*, e afër me ind. e vj. *ās* «gojë» lat *ōs* «gojë» shm. *ōra* «bregdet»; *unazë*, nga në \**úna-zē*, \**únē-zē* «unazë e vogël»: ind. e vj. *vandhúra-* «kosh (i thurur)», arm. *gind* «unazë», got. anglos. saks. e vj. *windan* gjerm. *wenden* «me sjellë, me kthye», *winden* «me përdredhë, me thurë, me pështjellë»; *punë*, si vazhdim i një baze \**pondā* fjalë e afër me lat. *pondus* «peshë», ose, si \*(s)po *ndā* fjalë e afër me gr. πόνος «punë e rëndë, mundim, brengë». Ky ndërrim fonetik është me rëndësi, për arësye se përshkon edhe sistemin gramatikor të shqipes. Nga ky sistem hyjnë këtu, me *-në-në* e tyre të dalë prej *-nt-*, kallzorja e shquar e tipit *nusenë* e *zënë zanë* «zërin»<sup>36</sup>, disa trajta foljore të prezentit si *janë*, *kanë*, *puthinë*<sup>37</sup>, aoristi i tipit *lidhnë lidhë*<sup>38</sup>, e treta vete e shumësit të mediopasivit tipi *vishenë*<sup>39</sup>, e cila i përgjigjet kështu kryekrejtet hetit. *uessanta* që ka të njëjtin kuptim; khs. edhe pjesoret e tipit *dhanë*, *dhënë*, *lanë lënë*, të cilat unë i gjykoj disi ndryshe nga M. La Piana<sup>40</sup>. Nga fusha e toponomastikës khs. *Kunavljā*-n mesjetare në raport me *Candavia*-n e kohës antike. Një *ng* të lashtë përmban fjala *an anë*, shm. *enë*: gr. ἄγγος «enë, kupë» ἀγγεῖον «enë», irl. e vj. *aigen* «patena, patella», kjo jo refleks i një baze \**auk<sup>u</sup>-nā* dhe si e tillë e afër me ind. e vj. *ukhāh* «vorbë, kuth, vegsh» lat. *aulla* «vegsh» got. *aúhns* «sobë, stufë» angl. e vj. *obnet* «enë e vogël, as e afër me gr. ἔντεα «armë, vegla»; te kjo *anë* hyn edhe *aní*, *anije*, si e ka vënë re M. E. Schmidt<sup>41</sup>. Te preemrat pronorë ynë fem. *jonë*, shm. *tanë* fem. *tona* me gjithë trajtat e tyre, hundorja *n* rrjedh nga përemri vetor *na* i rasës së zhdrejtë; aty rotacizmi, me gjithë moshën e madhe të këtyre kompozitave, nuk u zbatua në toskërishten, për punë të ruajtjes së sistemit. Te *unë*, *tinë* përkundrazi elementi *-në* zuri vend më vonë, në një kohë kur rotacizmi më nuk vepronte.

Prej kësaj rregulle del si rrjedhim, që *nd*, *ng-të* e sotme të gjuhës kanë dalë të gjitha me rrugë sekundare: një pjesë nga *nt*, *nk* (*landë lëndë*: lit. *lentā* «dërrasë», *kangë këngë* nga lat. *canticum*); një pjesë me epentezë popullore të një *n-je* (*hundë*, *drangua drangue* prej lat. *draconem*, në

35) Albanorumänische Studien I 95 vv. — *Language* 28, 40.

36) Pedersen *Festskrift til V. Thomsen* 249; KZ 34, 288; 36, 310.

37) Bopp 470, G. Meyer *Alb. Grammatik* 38 § 38.

38) Jokl *Ling. — kult. Untersuchungen* 26.

39) Kamarda I 288.

40) *Intorno al riflesso della vocale «o» lunga dall'Indoeuropeo e dal Latino nell'Albanese* 26 shën. 1.

41) Kz 50, 235.

kohët e fundit *andresë*, *barangë* etj.). Në përfitim të grupit *nd* ka pjesë nganjëherë dhe epenteza e një *d*-je, *andër ëndër*: gr. ὄνειρος arm. *anurj*. Më me rëndësi është shfaqja e një *d*-je si okluziv homorganik pas një *n*-je në fund fjale, si në huazime të llojit *shend* prej turq. *şen*, *pelind* prej sllav. *pelin*, ashtu edhe në fjalë vendi si *kund* me kompozitat *gjëkund* *gjakund*, *gjithkund*, *kurrkund*, si *moskund*: *ku*; *kënd*; *kë*, te Gjon Buzuku e Pjetër Budi *kana*, *kanaj*; *send*, substantivim i përemrit pyetës *se* në *me se?*, *përse* etj., *bind* përballë *bë-së* e *besë-s*, *dend* përballë *dej*, *lind* pranë *lēj*, *mënd* «i jap gji foshnjes; vë qengjin të pijë te një tjetër dele, kur i ka ngordhur e ëma», *mund* pranë *sëmunë sëmurë* etj.<sup>42</sup>

7. Grupi indoeuropian *vr-* në ballë të fjalës ruhet pas mendimit të Gustav Meyerit<sup>43</sup>, i cili afron fjalën *vrap*: me gr. φρέπω «përkulem, prirem nga një anë» lit. *virpiū* «dridhem» etj. dhe e sheh veten të detyruar që të tërheqë mendimin e tij të mëparmin për fjalën *resh*. *reshën* «bie borë», nga një bazë \**vresh* \**vers-*, në lidhje afërie me ind. e vj. *varšām* «shi», gr. Φέρση «vesë», irl. e mesme *frass* «shi, shi rusgjerm». Me të drejtë L. Spitzeri<sup>44</sup> i del zot mendimit që *ur-* në shqipen zhvillohet në *r-* po ashtu si në latinishten e sllavishten, duke e nxjerrë ai fjalën *rrënjë rràje* (ku hyn edhe *rrëzë rranxë*) nga një bazë \**uradriā* e duke e afruar me lat. *radix* «rrënjë», gr. ράδιος. Mendimin e një zhvillimi indoeur. *ul-* e *ur-*: shq. *l-* e *r-* në ballë fjale e mbron edhe Bariçi si një ndërrim fonetik të kushtëzuar, të kryer në sandhi pas një fjale që mbaronte me zanore, në fjalë të tilla si *lesh*: ind. e vj. *ūrṇā* lit. *vilna* got. *wulla* lat. *lana* «lesh», ose e afër me gr. λάχνη «flok kaçarrel», i rëndë i *randë*: gr. ἀείρω αἶρω «ngrë» lit. *sveriu* «peshoj» *svarūs* «i rëndë» gjerm. e lartë e vj. *swāri swār* «i rëndë», *ruaj ruej*: gjerm. e lartë e vj. *biwarōn* «me ruejtë» lat. *ve-reor* «shikoj me frikë e me nderim, nderoj, druaj» gr. ἐπί ῥρονται «mbikëqyrin» φρουρός «roje» etj.; le të vërejmë në këtë mes që krahasimi i fjalës *lesh* me gr. λάχνος «flok kaçarrel» gjindet më parë te Kristoforidhi f. 205, dhe krahasimi *lesh*: sllav. e vj. kishtare *vlasъ* «capillus», i cili paravendon ndërrimin *ul-*: *l-* në pozicion nistor që na intereson në këtu, haset te Gustav Meyerit në një vepër të mëparme (Alb. Studien I 40). Një fjalë vendi gjen Vasmeri te *lag*, duke e venduar te grupi anglos. *wloec wlacu* «i vakët» (në thelb «i lagët»), lit. *vilgau vilgyti* «lag», sllav. e vj. kishtare *vлага* «lagështi»; po ashtu edhe fjalën *lesh*, si vazhdim të një \**vlaks* ose \**vlōks*, ai e lidh me gr. λάχνη e λάχνος<sup>45</sup>. Disa rasa të tjera, shumica të pasigurta, gjinden te Bariçi (në vendin e cituar) edhe te Manni Language 28, 37. Për një ndërrim *ul* : *l-*, përveç shembëjve më sipër, dëshmon dhe fjala *lëmsh lamsh*, që e kanë shpjeguar gjer tani gabimisht nga lat. *glomus* ose *glemus* «lëmsh», e që si fjalë vendi afrohet me gr. εἰλύω «rrokulloj, rrotulloj», lat. *volvo* «rrotulloj, sjell, vërtit» etj. Për *ur-*: *r-* edhe *rē roe oroe* në shprehjen *vë rē*, e cila, sikundër vren Jokli<sup>46</sup>, shkon me *ruaj*, që u zu ngoje më sipër; *rē*, afruar me të drejtë nga ana e Hahnit, Kupitorit e Joklit<sup>47</sup> me enotr. ρινός · ἀχλός «errësirë»; *regj* «punoj lëku-

42) Khs. edhe autorin, Buletin për Shkenecat Shoqërore 1953 Nr. 4, f. 30 vv.

43) Alb. Studien III 38 v. § 67 v.

44) Mitteil. d. Rum. Instituts Wien I 327.

45) Studien z. alb. Wortforschung I 37 v.

46) Studien 75 v., Ling. — kult. Untersuchungen 207.

47) Alb. Studien I 250. — Μελέτη περί τῆς γλώσσας καὶ τοῦ ἔθνους τῶν Ἀλβανῶν (1879) 49. — Archiv für slav. Philologie 31, 238, Realexikon der Vorgeschichte I 86. Khs. edhe Krahen, Die Sprache der Illyrier I 38, sëfundi vrejitet tona Rendiconti Istituto Lombardo 99 (1965) 216.

rët; bëj turshi specat, trangujt, domatet etj.»: arm. *gorc* «vepër» gr. *Ἐργον ἔργον* «vepër, punë», gjerm. *Werk* «vepër» etj., khs. për kuptimin e fjalës gr. e mesme e të renë *εργάζω* «regj»: *ἔργον*; *resh reshën*, për të cilën shih më sipër. Prej kësaj rregulle del që trajtat e sotme të fjalëve që nisnin me *vl-*, *vr-*, si *vloj*, *vrap*, *vranët vrërët*, *vrëndë* «shi i hollë» etj., nuk janë të lashta në gjuhën shqipe.

8. Ç'i përket më në fund reflektimit të *r*-së indoeuropiane si tingull më vete, dihet se pranohet përgjithësisht që ajo në gjuhën shqipe ka dhënë *r* alveolare të parme, dhe që vetëm në ballë të fjalës reflektohet me një *r*-alveolare të mbrapme e fort të rrotulluar (që shkruhet *rr*), si bie fjala në *rrotë* nga lat. *rota*. Ky tingull i fundit, si në trup si në fund fjale, që prej Miklosichit e këtej është bërë zakon të merret si produkt asimilimi i grupit *rn*, p.sh. *furrë* nga lat. *furnus*, *marr* si një prezent hundor \**marn-*. Unë edhe këtu jam në kundërshtim të prerë me mendimin që ka zotëruar gjer më sot. Në disa fjalë të sferës emocionale të ngarkuara me afekt, intensiteti i veçantë që synon të arrijë folësi, arrihet me këtë rrugë, që *r*-ja pëson një shqiptim më të fortë, që ajo ndërrohet spontanisht në *rr*. Me këtë mënyrë në të folët dialektor ose të rastit ndihen shqiptime të tilla si *andërr ëndërr* pranë *andër ëndër*, *dhandërr dhëndërr* pranë *dhandër dhëndër*, *krromë* për *kromë* (*kruaj*), *parrajsë* për *paraajsë* nga gr. e re. *παράδεισος*, *rruazë* (Budi *Speculum Confessionis* 319 *rruzëtë*) për *ruazë*, *surrat* prej turq. *surat*, *shpirrë* për *shpirë* prej lat. *spirare*, *shqarr* pranë *shqar shqarth* edhe me kuptimin «njeri dinak, dhelpër», *tmerr* pranë *tmer*, *i tharrët* për *i tharët*, *thërria* shm. për *thëria* geg. *thënia*, *zorr* për *zor*, *me zorr*. Nga një i tillë shqiptim i disa fjalëve të caktuara e më fort dialektore, dhe nga disa të tjera, si *burnot* figurshëm për *burnot* prej turq. *burun otu*, *doktorri*, *fiçorr* prej arom. *ficior*, *gaforre* prej gr. së re. *γάβορας*, *gorrën* «erë e veriut» prej bullg. *goren*, *horr* prej turq. *hór*, *kaptërr*, *mavzerre*, *motorri*, *poturr*, mund të mendohet një shqiptim i tillë edhe për faza më të vjetra të gjuhës. Shohim kështu që *fundërrri* (edhe figurshëm «zgaq») shkon me *fund*, *gërrryej* bashkë me *gërric* me *grij*, *grremç* me *grep*, *kërric* «i vogli i gomarit, visk», me *kër* «i përhimë» nga turq. *kir* (khs. gjerm. *Grauchen Grautier* «gomar»: *grau* «i përhimë»), *kurrë* «asniëherë», edhe «ndonjëherë», me *kūr*, *ngurroj* me *gur*; edhe *mburroj*, të cilën Gustav Meyer i f. 267 e bie të ardhur nga it. *barrare*, *sbarrare* «mbyll, pengoj», nuk është gjë tjetër veçse *mburoj* e *proj* prej lat. *parare* «me gatitë». Kështu shpjegohen ndër të tjera edhe *angërr* «lëkurë që mbështjell ndonjë gjymtyrë a lëng të trupit», *barrë*, *bërrakë*, *bërryl* *bërrul*, *burrë*, *cakorre*, *curr*, *derr*, *dokrra* shm., *ferrë*, *gabzërr*, *hakrrri* *hakrrohëm*, *hërrë*, *mbarre*, *morr*, *përrallë* nga lat. *parabola*, *pirrë* «Sesleria» *pirra* «gëmusha, ferra» nga sllav. *pír*, *rrej* bashkë me *errë* e *terr* (të gjitha nga *rë-ja*), *sorrë* përkundrejt rum. *cioară*, *shkatërroj* *ngatërroj* (*katër*), *shporr*, *shtërroj* «rrëgjohem»: *shter*, *thërras* *thërres*, *thërtime*, *urrej*, *varrë*, *vorr* *varr*, *zjarr* pranë *zjarm*, *zorrë*. Kështu edhe sufiksi *zvo-gëlues -ërr* në fjalë si *kokërr*, *i vocërr*, i konstatuar prej Heibout dhe Joklit<sup>48</sup>, është një me *-ër* si në *askathër*, *flatër*. Është gjë me rëndësi për fonetikën historike dhe historinë e fjalëve të shqipes, dhe jo pa peshë edhe për studimet krahasimtare, kur këto e të tjera elemente si këto të leksikut të saj, me një mënyrë që qëndron më afër realitetit gjuhësor, të interpretohen me mjete të brendshme, e të hiqet dorë nga ndërtimi

48) X. Jahresbericht des Rum. Instituts Leipzig 64 — Archivum Romanicum XXIV f. 29 e botimit të veçantë.

i disa formave bazë me *-rn-* shpeshherë arbitrare e të pabesueshme, ngandongëherë edhe mjaft artificioze, për të shpjeguar *rr-në* e këtyre elementeve.

Në lidhje me kronologjinë do vërejtur se te ndërrimet fonetike që u përshkruan këtu, në pjesën më të madhe kemi të bëjmë me procese të lashta, të periodës prehistorike, në të cilat huazimet latine të shqipes shumica nuk marrin pjesë. Aty hyn veçanërisht ndërrimi i *i-së* nistore në *z-*, zhdukja e *v-së* së grupeve *vl- vr-*, rregullimi i likuideve e nazaleve silabike, i guturaleve e i grupit *nt*, asimilimi i të cilit tek elementi latin ka arritur vetëm gjer në *nd*, jo gjer në *n*, *conventus: kuvënd*. Në kundërshtim me këto, ndërrimi i: *gj* në ballë fjale, dhe nga fusha e grupeve konsonantike ndërrimi *ks: sh*, përveç elementit të trashëguar rrok edhe elementin latin, *iudicium: gjyq*, *fraxinus: frashër*, sh. më lart f. 83; prandaj këto zhvillime janë më të reja ose të paktën kanë zgjatur më shumë se ndërrimet fonetike që sapo u zunë ngoje më sipër. Afërsisht kështu do gjykuar në pikëpamje kronologjike edhe ndërrimi *dj: z* që u përmënd më lart f. 83; atij i shtrohen si fjalët e vendit (*máz mész*, khs. mesap. *Iuppiter Menzana*), si huazimet latine të hershmet (*gaudium: gaz*), po jo më ato që depërtuan më vonë, khs. *Diana: zanë zërë* të kohës pagane me *diabolus: djall* të epokës kristiane. Në këtë periodë prehistorike-historike do venduar dhe delabializimi i të ashtuquajturave labiovelare përpara zanoreve të mbrapme në fjalë vendi si *kë, ku, djeg*, meqë në këtë ndërrim marrin pjesë dhe huazime latine si *caçile kashile* prej *quasillus, kartë* «masë drithi» prej *quarta quartus*. I paqartë mbetet raporti kronologjik midis metafonisë dhe palatalizimit të guturaleve, të dyja këto dukuri të brendshme të gjuhës dhe me lidhje kauzale në mes të tyre, pra çështja nëse sidomos në rrasa të tilla si *kalb: qelb, kall: qell*, lat. *calcaria: këllqere, scabies: zgjebe*, në *plak: shm. pleq*, të cilat për një pjesë u zunë ngoje dhe më lart, pas shkallës së zbutimit konsonantik erdhi shkalla e metafonisë apo ansjelltas. Shumë më vonë se proceset që u parashtruan këtu do datuar pjesa e dytë e ndërrimit dy shkallësh palatal indoeuropian: afrikatë e shqipes dhe këndeje spirant interdental i shqipes (*k': ç c: th, g' g'h: xh x: dh*) në fjalë si *bathë, lidh* etj., sepse ky spirant sipas paraqitjes bindëse të N. Joklit<sup>49</sup> në gjuhën shqipe nuk është përfutuar më parë se në kohën nga shekulli i VIII. i erës sonë e këtej. Këtë gjë nga një anë tjetër, sikundër e kam treguar unë vetë<sup>50</sup>, e vërtetojnë dhe huazimet mesjetare që kanë kaluar prej shqipes në gjuhët fqinje, si p.sh. gr. e re *τάρχος* «shtallë e vogël për dhi ftuja» me rum. *țarc* «vathë, rrethim, thurimë», marrë nga shkalla e përparme e të sotmes *thark* të shqipes. Për kohën e përfutimit të reduktimit të diftongjeve të lashta në monoftongje, dorajdorën nuk jam në gjendje të them asgjë të prerë, me përjashtim mbase të *au*, i cili ka përfshirë edhe huazimet latine, *aurum: ar* pranë *causa: kafshë*. Për formimin e diftongjeve të periodës vetiake, postetnike të shqipes, në lidhje me një kronologji relative desha të vërej vetëm këtë, që diftongimi i *e-së* së shkurtër në *je* dhe në *ja* në fjalë vendi e në huazime (*dhjetë, jes* «mbes, mbetem» bashkë me *jetë, mjek* prej lat. *me-*

49) *Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen. Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg* (1929) 111 vv.

50) *Zeitschrift für Balkanologie* II 17 vv., Revistë Shkencore e Institutit Pedagogjik dyvjeçar Shkodër I 14 vv.

*dicus, jeremi* prej gr. së re ἐρημία; *jam* nga një \**esmi, mjaltë* nga një \**mel-*) u zhvillua më vonë se asibilimi i *tj-së* në *s* e i *dj-së* në *z* që u trajtua më sipër; këtë e vërteton moszbatimi i këtij asibilimi në rasi të tilla si *atje, tjerr, si tjegull*, nga lat. *tegula*, si *djeg*: lit. *degù, djeg, djalë* nga një \**del, i djathtë*: lat. *dexter*, gr. δεξιός. Me fjalë të tjera, asibilimi *tj: s, dj: z*, në kohën e shfaqjes së këtyre dy diftongjeve ishte i kryer, i përfunduar. Këndeji rrjedh si korolar, që të sotmet *sa se, za ze*, në çdo pozicion qofshin, nuk burojnë nga *tja, tje, dja, dje*, po nga tinguj të tjerë. Aty le të shtojmë për plotësim edhe këtë vërejtje, që veçanërisht diftongimi *e: je* jo vetëm — sikundër u tregua këtu — përballë konsonantizmit, po edhe përballë vokalizmit hap shtegun për të vënë re një raport kronologjic. Fakti që *e-ja* e rrjedhur nga një *o* e gjatë, në fjalë të fondit të trashëguar dhe në huazimet e lashta nuk merr pjesë në këtë diftongim: *pelë*: gr. πῶλος «mëz», *tetë*: gr. τετὼ lat. *octō, pemë* prej lat. *pōma*, na vërteton se në kohën e hyrjes së këtij diftongimi në fuqi, *o-ja* e gjatë nuk kishte arritur në shkallën *e*, po vetëm gjer te një zanore që gjindej në mes të *o-së* së gjatë dhe *e-së* së sotme. Vetëm te rregullimi i ndryshimeve të kuantitetit kemi të bëjmë me një dukuri njëkohësisht të moçme dhe të re, e cila përshton si të thuash gjithë historinë e gjuhës. Relativisht i ri është geminacioni ekspresiv i tingullit *r*, një proces që është në veprim dhe sot e gjithë ditën. Edhe ky ndërrim fonetik ndërkaq është i një farë moshe, meqë në ligjërimet që fliten në Greqi e n'Itali, në fjalët që u dhënë më sipër na paraqitet i zbatuar në mënyrë mjaft konsekuente. Mungesa e tij sidomos te Gjon Buzuku 1555 (*barë, bërakë, bura, furi, kurajtë, luqërenë, përallë, ranzët, reziku, ri, qi i ruonjënë* «tondente», *rush, turë, varë* shm. «plagë») në këtë mes nuk mund të lihet mënjanë, po me gjith' atë gjan të ketë të bëjë me disa rrethana dialektore.

«Lënda vetë, gjuha shqipe, është një lëndë fort e vështirë, në konsonantizëm edhe më shumë se në vokalizëm. Kështu që do të duhet pas gjase edhe shumë punë gjersa gjithshka të gjejë vendin e vet e të sqarohet». Që kur Meyer-Lübke shkroi këto fjalë përpara më se dy brezave<sup>51</sup>, në këtë fushë janë kryer përparime të shënueshme. Rezultati i këtyre është që sidomos pamja e pozicionit të shqipes në rreth të gjuhëve motra ka marrë kontura më të qarta. Disa konkordanca të veçanta që janë caktuar më parë me njërën ose tjetrën nga ato gjuhë, duke qenë të gabuara bien poshtë, disa të tjera, të pavëna re më parë, ua zënë vendin atyre. e disa të tjera duhet të merren si irelevante në punë të këtij pozicioni. Këndeji rrjedh që përpjekjet për të caktuar këtë pozicion në bazë të një interpretimi më të vjetër të materialit, pa marrë parasysh rezultatet e mëpastajme, nuk i përgjigjen më gjendjes reale. Një pamje e ngjashme me këtë na paraqitet tani edhe me elementin latin të gjuhës shqipe. Aty, me një analizë të zgjeruar të lëndës gjuhësore, mbeten jashtë disa qindra huazime të pranuar më parë. Me këtë gjë shpërngulen në një masë të ndieshme sidomos përpjestimet madhësore përkundrejt visarit leksikor të trashëguar; e m'anë tjetër bien poshtë, si të papajtueshme me gjendjen e vërtetë, grupimet e ndryshme të këtij elementi të huazuar, qoftë në një drejtim qoftë në një tjetër, me këto ose me ato gjuhë romane. Me gjithë këto rezultate të gjuhësisë shqiptare fjalët e Meyer-Lübkes edhe sot ruajnë vlerën e tyre. Jo pak pika që më parë mbahehin

51) *Indogerm. Anzeiger* 2, 1893, f. 184, me rastin e një recensioni të veprës Alb. Studien (Studime shqiptare) III (Fonetika e elementeve indoeuropiane të shqipes) të Gustav Meyerit.

për njohuri të vërteta, kanë filluar ndërkaq të lëkunden, e disa të tjera janë lënë fare mënjanë. Shumë probleme prandaj presin të zgjidhen, te shumë zgjidhje duhet të kthehemi e t'i rishikojmë.

### R é s u m é

#### A PROPOS DE QUELQUES REGLES PHONETIQUES DE L'ALBANAIS

Dans le domaine de la phonétique historique de l'albanais, malgré les succès obtenus jusqu'ici, il subsiste des problèmes qui avec une nouvelle considération des matériaux et un examen plus rigoureux des lois internes de la langue, peuvent s'approcher à une solution définitive.

1. Les oppositions de quantité vocalique, expliquées jusqu'à présent surtout par l'ambiance syllabique de la voyelle et par le caractère et le nombre des consonnes suivantes, ont des raisons d'ordre historique. Les voyelles longues proviennent d'une part de longueurs originaires de date indo-européennes, type *mī* «souris»: gr. μῖς lat. *mūs*, mais surtout d'une contraction vocalique, de la chute d'une syllabe, type *mjĕk* «médecin» du lat. *medicus*, *bĕ* «serment», le proche parent du sl. *bĕda* «nécessité», *hĭj* «entrer»: vieux sl. *choditi* «incedere», *mpij* «engourdir»: gr. πάγος «glaçon, gelée». Les oppositions de quantité comportent aussi, dans une certaine mesure, des différences d'ordre sémantique et grammatical. De nombreuses interférences ont nivelé pourtant, surtout dans la dernière phase de l'évolution linguistique, ces oppositions dans une bonne partie, menant ainsi généralement à une quantité isochrone des voyelles.

2. La règle phonétique selon laquelle les diphtongues indo-européennes *oi*, *ai* ont abouti à *e* en albanais, ne peut être considérée bien établie. Les exemples apportés par G. Meyer au soutien de cette règle, contiennent pour la plupart un *e* secondaire. Par contre, des mots comme *gjaj* «sembler, rassembler; convenir»: got. *galeiks* all. *gleich* «égal, pareil» angl. *like* «semblable, pareil, égal, comme»; lit. *lygus* «pareil», *āj ėnjt* «gonfler, enfler»: arm. *aitnum* «j'enfle», gr. οἰδᾶω «s'enfler, se gonfler» lat. *aemidus* «tumidus, inflatus» all. *Eiter* «pus», le pronom *-ta* dans *kĕtā* «ceux-ci» *atā* «ceux-là», militent en faveur d'une évolution *oi*, *ai*: alb. *a*.

3. A propos des sonantes, la continuation du *r* syllabique indo-européen par *ri* est aussi bien douteuse. Des mots apportés à son appui, *dritĕ* «lumière» fait rime avec *dītĕ* «jour», et à côté de *krimb* «ver» il y a *karrĕm* «lombric»; *brimĕ* «trou» est un postverbal de *brij*, *brej* «ronger»; de la même nature secondaire sont à considérer les verbes *grij* «hacher menu», *ngrij* «geler, être transi», *shtrij* «étendre».

4. Une des questions les plus ardues du consonantisme albanais est le problème des gutturales. Contrairement à l'avis de G. Meyer et d'accord avec H. Pedersen, nous considérons que les palatales indo-européennes ont développé en albanais seulement des spirantes interdentes, à savoir *k'*: *th*, *g'* *g'h*: *dh* et aussi *d*. Les mots contenant un *s* ou un *z*, comportent une interprétation d'autre caractère. Ainsi donc, *vise* «lieux, endroits, places», loin d'être le parent de gr. Φῶχος, lat. *vicus*, etc., n'est que l'ancien pluriel de *vend* «lieu, localité, pays, endroit». Le *z*- de mots comme *-zet* dans *nĭzĕt* «vingt» *dĭzĕt* «quarante», *zĕmer zamĕr* «après-midi; goûter», *i zi* «noir», *ziej* «bouillir, cuire, fermenter», *zog* «oiseau; petit des oiseaux; petit des animaux», remonte à un *i* (*j*) de l'indo-européen, par une évolution phonétique semblable à celle du grec. Cit. entre autres *-zet*: gr. ζευκτός «attelé, joint, réuni», *zog*: arm. *jag* «jeune oiseau, petit oiseau», perse moderne *zāq* «petit d'un animal», gr. ἄβη «force juvénile, âge de la force, jeunesse». Chronologie des divers *z* de l'albanais. Quant aux labiovélares, leur assimilation en albanais devant une voyelle antérieure

est comparable à leur dentalisation en grec dans la même position. En ce qui concerne enfin les ainsi-dites vélares pures, contrairement à la thèse de H. Pedersen et d'accord avec celle de E. Hermann, nous sommes de l'avis que l'actuelle palatale dans des mots tels que *ergjëz* «œufs de poux», *dergjem* «être alité», *gjej* «trouver», *qell* «porter, emmener», *qeth* «tondre», est d'ordre secondaire; elle est issue notamment par une métaphonie interne, de la période historique de la langue. Il importe de souligner qu'il y a eu en albanais deux palatalisations successives, comme dans les langues slaves.

5. L'ancien groupe *s* + gutturale a abouti en albanais, dans certaines conditions, à la sifflante *sh*, comme dans *fsheh* «cacher», *mëshël mbërshël* «fermer» face à *çel* «ouvrir», *shaj* «insulter, injurier, railler» face à *çaj* «fendre», *shalë* «partie intérieure de la cuisse; jambe» face à *i çalë* «boiteux», mot apparenté au gr. *σκέλος* «jambe» à côté de *σκολιός* «oblique, tortueux»; à confronter aussi *shalës* «sorte de terrain»: ail. *Scholle* «motte de terre», etc. Même résultat à admettre pour le groupe opposé *ks*, *push* «duvet, coton de certains fruits»: russe *puch* «plume légère, duvet, cheveux fins et laineux des animaux», lit. *paustis* «cheveux des animaux»; *trishë tresh* «greffe; jet, pousse, scion, rejeton»: gr. *τέρχνος* *τέρχνος* «jeune pousse, branche».

6. Contrairement à l'opinion presque générale, nous soutenons que les anciens groupes *nt*, *nd* et *ng*, à travers une assimilation à *nn*, ont donné *n* en albanais, un phonème qui n'a plus subi le rhotacisme en tosqe. Cfr. *anë* «côté, extrémité, bout, bord, rivage; demi-charge de cheval»: anc. ind. *ánta-h* «fin, borne, extrémité», got. *andais*, all. *Ende* «fin, terme», cfr. l'alb. *në të katër anët*: *alla an allen vier Enden*; *unazë* «bague, anneau; petit cercle de fer»: anc. ind. *vandhûra* «manne d'osier. banné», arm. *gind* «bague», got. ags. *windan* all. *wenden* «tourner, retourner», *winden* «tordre, tortiller»; *punë* «travail»; lat. *pondus* «poids» ou gr. *πόνος* «peine, fatigue, travail fatigant»; *an*, *enë* «vase, pot; vaisseau»: gr. *ἄγγος* «vase; corbeille; coffre» *ἄγγειον* «vase, vaisseau», irl. *aigen* «patena, patella». Ce même changement phonétique apparaît aussi dans des formes grammaticales du système nominal aussi bien que verbal. Les actuels groupes *nd*, *ng* résultent de procès ultérieurs. A noter surtout la présence d'un *d* secondaire en fin de mot, comme dans *kund* «quelque part»: *ku* «où», *send* «objet, chose»: *se* «quoi», *lind* «naître», *mund* «je peux», etc.

7. Contrairement à l'avis de G. Meyer, et d'accord avec L. Spitzer, H. Barić, M. Vasmer et d'autres savants, nous retenons que les groupes initiaux *vr-* et *vl-* se sont réduits à *r-*, *l-*: *rrënjë rranjë rräjë* «racine»: lat. *radix* gr. *ράδαμος* «jeune branche, rejeton»; *resh* dans *resh borë* «il neige» *pë resh shi* «il pleut»: anc. ind. *varšá-* «pluie», gr. *ἔρση* «rosée», irl. *frass* «pluie»; *ruaj ruej* «garder, faire la garde, observer»: lat. *vereor*, anc. haut all. *biwarôn* «surveiller»; *lag* «mouiller, humecter»: vieux sl. *vlaga* «humidité»; *lëmsh lamsh* «écheveau, peloton de laine»: gr. *εἰλώω* «rouler, envelopper», lat. *volvo* «rouler, faire rouler».

8. L'opinion dominante depuis F. Miklosich, que l'actuel *r* roulé de l'albanais provient toujours, à l'intérieur et à la fin du mot, du groupe *rn*, n'est pas exacte. Ce phonème est souvent issu d'une gémiation expressive relativement tardive dans des mots de la sphère affective, tels que *andërr ëndërr* «rêve», *parrajsë* «paradis», *tmerr* «terreur», *gorrën* «vent du nord», et dans d'autres, comme *burrë* «homme, mâle», *derr* «porc, cochon», *ferrë* «ronce, roncier, buisson», *kurrë* «jamais», *mbarre* «honte, outrage», *rrej* «mentir», *thërrás thërres* «appeler, inviter, crier», *thërrimë* «miette», *urrej* «haïr», *varrë* «plaie», *vorr varr* «tombeau», *zorrë* pl. «entrailles, intestins, boyaux». Par cette manière d'envisager les choses on évite la reconstruction d'anciennes formes de base arbitraires, et souvent artificielles et irrélles.

Ces nouvelles formulations de règles phonétiques comportent aussi des précisions d'ordre chronologique, d'une chronologie absolue et relative. Sans rentrer ici dans des détails, on peut retenir que les éléments latins de l'albanais contribuent

à arriver ici aussi à des résultats plus concrets. Pour donner un exemple, la diphtongaison de l'ancien *e* à *je* et *ja* (*dhjetë* «dix», *dje* «hier», *i djathtë* «droit») est postérieur à l'assibilation *tj:s* et *dj:z*, dans *Diana:zanë zërë*, etc. Ce qui est plus important encore, l'étude approfondie des principes et des règles qui ont amené le système phonétique de l'albanais à son état actuel, unie à une meilleure connaissance et une plus rationnelle mise en valeur des matériaux, est destinée à mieux préciser la position de cette langue dans le cadre indo-européen, en remplaçant des opinions pour une bonne part vieilles par des vues nouvelles. La même chose vaut pour l'élément latin de l'albanais. Ici aussi l'élimination de beaucoup de fausses interprétations est indiquée à modifier les rapports admis jusque-là et même à entreprendre des déplacements de position linguistique.

